



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 17.03.2022		
Prilajeno:		
Njësia Jednica	Numr Broj	Shtojca Dodatak
1-020/01-14729		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e Kryetarit të Komunës

Datë:	17.03.2022
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi –Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Diamant Bytyqi– Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport 
Lënda:	Raport: Planin e Veprimit Rinor Lokal Lipjan 2022-2024

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni punues ka shpall në Diskutim Publik – Planin e Veprimit Rinor Lokal Lipjan 2022-2024 dhe me datën 22.02.2022 është

mbajtur tryezë e diskutimit me akterë të ndryshëm dhe grupe të tjera të interesit në bashkëpunim me OSBE-në

Ecuria e Procesit

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, në harmoni me ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna dhe në bashkëpunim me koordinatorin për konsultime publike ka publikuar në web faqen e komunës Njoftimin për Planin e Veprimit Rinor Lokal Lipjan 2022-2024

Shih linqet:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/shqyrtimet-publike/>

Po ashtu kjo projekt rregullore është publikuar edhe ne platformën e qeverise për konsultime publike.

linku: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41328>

Njoftimi për diskutim publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, duke u bazuar në nenin 16 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, po ashtu palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin, kohën për mbajtjen e takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i shqyrtimeve publike ku ka qenë në diskutim publik Plani i Veprimit Rinor Lokal Lipjan 2022-2024 si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	30 ditë pranohen	25
2. Publikimi në ueb faqe	30 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **25** pjesëmarrës, prej tyre **09** femra dhe **16** meshkuj.

Pjesëmarrës në këtë diskutim publik ishte edhe Nënkryetari Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi, Kryesuesi i Kuvendit Komunal Lipjan, Daut Azemi, Zyrtar nga Drejtoria Kulturës Rinisë dhe Sportit, Selman Jashanica, antarë të Kuvendit Komunal Lipjan, përfaqësues të shoqërisë civile, OJQ si dhe qytetarë të tjerë.

Në këtë takim, Selman Jashanica shef i sektorit për kulturë ka prezantuar Planin e Veprimit Rinor Lokal Lipjan 2022-2024, ka njoftuar të pranishmit për qëllimin e debatit si dhe dispozitat e përgjithshme të planit. Duke shtuar se Plani i veprimit rinor lokal është hartuar nga Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile me mbështetjen e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Selman Jashanica po ashtu ka theksuar se në këtë proces janë përfshirë të rinjtë e komunës së Lipjanit të cilët jetojnë në qytet dhe në fshatrat, organizatat e shoqërisë civile të cilat veprojnë në Lipjan, forumet politike rinore si dhe përfaqësuesit institucional siç janë kuvendaret e komunës së Lipjanit.

Plani i veprimit rinor lokal 2022-2024 është hartuar nëpërmjet një procesi të gjerë konsultativ, janë zhvilluar me dhjetëra takime konsultuese me të rinjë e të reja dhe me përfaqësuesit e Komunës së Lipjanit gjatë vitit 2021 me qëllim vendosjen e prioriteteve strategjike dhe objektivave që ndikojnë në përmirësimin e jetës social, kulturore, ekonomike dhe përfshirjes së të rinjve në jetën publike në Lipjan.

Ndërsa, Nënkryetari Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi i cili ka qenë prezent, ka hapur debatin për pjesëmarrësit ku është mundësuar që të bëhet debat në të mirë

të këtij plani, nënkryetari Bytyqi është shprehur se çdo kërkesë, sugjerim apo vërejtje ndihmon këtë plan që të jetë më i zbatueshëm në të mirë të veprimit rinor lokal Lipjan 2022-2024.



Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet / komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)
Planin e Veprimit Rinor	Ka kërkuar që pjesë e këtij plani	Fjolla Hoxha nga KVRL	Anëtarët e Komisionit kanë	Komisioni punues ka pranuar komentin tërësisht.

Lokal Lipjan 2022- 2024	të jetë në një pikë edhe ndërgjegjës imi dhe fushatat vetëdijesue se në luftimin e dukurive negative në shkolla.		theksuar se është patjetër që do jetë në këtë plan me theks te veçantë edhe luftimi I dukurive negative ne institucionet arsimore të komunës së Lipjanit.	
Planin e Veprimit Rinor Lokal Lipjan 2022- 2024	Është kërkuar që pjesë e këtij plani të jetë edhe ndikimi i rrjeteve soacile në shoqëri	Feridan Shala nga YAHR	Komisioni ka pranuar së është tejet nevojshme që në kuadër të këtij planit të ketë edhe aktivitet apo trajnime që do të kenë fokus përdorimin e rrjeteve sociale	Koment : Komisioni ka pranuar kërkesën duk sygjeruar që në kuadër të këtij propozimi të ketë edhe trajnime mbi të dhënat personal në fushën e teknologjisë informative
Planin e Veprimit Rinor Lokal Lipjan 2022- 2024	ka ngritur disa çështje që duhen të sqarohen në këtë plan si për shembull forma e organizimit të	Shkelqim Bahtiri Ipko foundation,	Komisioni ka dhënë sqarimet e kërkuar gjate diskutimit publik në debat	Komentet: Komisioni ka konstatuar se janë dhënë të gjitha sqarimet rreth aktivitete dhe trajnimeve që do të organizohen në kuadër të planit gjatë debatit të diskutimit në publik

	trajnimeve të cilat janë cekur në këtë draft të Planit të veprimit Rinor Lokal			
Planin e Veprimit Rinor Lokal Lipjan 2022-2024	Ka kërkuar që në këtë plan të përfshihet barazia gjinore.	Gjyste Dabaj NDNJ	Anëtarët e Komisionit kanë theksuar se patjetër që do të përfshihet në këtë plan edhe barazia gjinore	Komentet: Komisioni punues ka pranuar pranuar komentin tërësisht.
Planin e Veprimit Rinor Lokal Lipjan 2022-2024	Sygjeroj që në kuadër të kësaj të kemi edhe një aktiviteti i cili do të kishte për qëllim zgjedhjen e aktivistit të vitit në kuadër të këtij planit	Rinor Murati	Anëtarët e Komisionit Kanë pranuar se ky sygjerim do të gjeje vend në kuadër të planit pasi që është aktiviteti i nevojshme për motivim të të rinjve	Komentet: Komisioni punues e ka pranuar kërkesën tërësisht

Shtojë: Lista e pjesëmarrësve



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lista e pjesëmarrësve prezantimi i Draft Planit Rinor Lokal Lipjan

Nr.	Emir dhe mbiemri	OJO / Subjekti politik	e-maili	Nënshtkrimi
1.	Albiona Tashmali	LDK	albiona.tashmali@gmail.com	
2.	Antigona Hyseni	YANR	antigona.hyseni@gmail.com	
3.	Gent Duga	YANR	gent.duga@gmail.com	
4.	Ferida Batfaj	KRL	ferida.batfaj@gmail.com	
5.	Fjolla Horrell	KRL	fjolla.horrell@gmail.com	
6.	Melrose Golioi	YANR	melrose.golioi@gmail.com	
7.	Jordan Shala	YANR	jordan.shala@gmail.com	
8.	Etesa Ardyli	KRL	etesa.ardyli@gmail.com	
9.	Polim Bardhona	AAK	polim.bardhona@gmail.com	
10.	Betel Krasni	YANR	betel.krasni@gmail.com	
11.	ARDIT CANI	PDK	ardit.can@gmail.com	
12.	Siklajin Bakhtin	IPKO Foundation	siklajin.bakhtin@gmail.com	
13.	Melrose Krasni	THE IDEAS PROMOTER	melrose.krasni@gmail.com	
14.	Adem Yllus	LDK	adem.yllus@gmail.com	
15.	Qytete Dardaj	YANR	qytete.dardaj@gmail.com	
16.	Mirza Buxte	Qytetore e Komunes	mirza.buxte@gmail.com	
17.	Halima Jevelli	Vizioni e Komunes	halima.jevelli@gmail.com	
18.	Aradin Javidi	Vizioni e Komunes	aradin.javidi@gmail.com	
19.	Enen Gjila	HOPE	enen.gjila@gmail.com	
20.	Islem Kalesha	KK Lypjan	islem.kalesha@gmail.com	
21.	Beard Tashaj	KK Lypjan	beard.tashaj@gmail.com	
22.	Hyra Buxte	Qytetore e Komunes	hyra.buxte@gmail.com	

Lipjan, 22 shkurt 2022

23. Daut Arëni Kryesues i Kuvendit

daut.arëni@lipjan.gov.kd

24. Bujana Zekaj

PKK

bujana.zekaj@lipjan.gov.kd

25. Rinor Buxte

Antigoni Kuvendit

rinor.buxte@lipjan.gov.kd

044/114 745